

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7952
E premte, 13 dhjetor 2024
Çmimi 0.50

Revista 'Time' përsëri shpall Trumpin person të vitit



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

PARTITË POLITIKE KANË DORËZUAR LISTAT E KANDIDATËVE PËR DEPUTETË NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE NË KOSOVË

PARTITË DORËZOJNË LISTAT PËR DEPUTETË, BROHORASIN PËR FITORE MË 9 SHKURT

PDK LISTA E KANDIDATËVE PËR DEPUTETË

1. Saliu Ibrahim
2. ...
3. ...
4. ...
5. ...
6. ...
7. ...
8. ...
9. ...
10. ...
11. ...
12. ...
13. ...
14. ...
15. ...
16. ...
17. ...
18. ...
19. ...
20. ...
21. ...
22. ...
23. ...
24. ...
25. ...
26. ...
27. ...
28. ...
29. ...
30. ...
31. ...
32. ...
33. ...
34. ...
35. ...
36. ...
37. ...
38. ...
39. ...
40. ...
41. ...
42. ...
43. ...
44. ...
45. ...
46. ...
47. ...
48. ...
49. ...
50. ...

LDK LISTA E KANDIDATËVE PËR DEPUTETË

1. Lumir Abdullahu
2. ...
3. ...
4. ...
5. ...
6. ...
7. ...
8. ...
9. ...
10. ...
11. ...
12. ...
13. ...
14. ...
15. ...
16. ...
17. ...
18. ...
19. ...
20. ...
21. ...
22. ...
23. ...
24. ...
25. ...
26. ...
27. ...
28. ...
29. ...
30. ...
31. ...
32. ...
33. ...
34. ...
35. ...
36. ...
37. ...
38. ...
39. ...
40. ...
41. ...
42. ...
43. ...
44. ...
45. ...
46. ...
47. ...
48. ...
49. ...
50. ...

LISTA E KANDIDATËVE PËR DEPUTETË

ALBIN KURTI KRYEMINISTËR

1. ALBIN KURTI
2. ...
3. ...
4. ...
5. ...
6. ...
7. ...
8. ...
9. ...
10. ...
11. ...
12. ...
13. ...
14. ...
15. ...
16. ...
17. ...
18. ...
19. ...
20. ...
21. ...
22. ...
23. ...
24. ...
25. ...
26. ...
27. ...
28. ...
29. ...
30. ...
31. ...
32. ...
33. ...
34. ...
35. ...
36. ...
37. ...
38. ...
39. ...
40. ...
41. ...
42. ...
43. ...
44. ...
45. ...
46. ...
47. ...
48. ...
49. ...
50. ...

AAK LISTA E KANDIDATËVE PËR DEPUTETË


1. ...
2. ...
3. ...
4. ...
5. ...
6. ...
7. ...
8. ...
9. ...
10. ...
11. ...
12. ...
13. ...
14. ...
15. ...
16. ...
17. ...
18. ...
19. ...
20. ...
21. ...
22. ...
23. ...
24. ...
25. ...
26. ...
27. ...
28. ...
29. ...
30. ...
31. ...
32. ...
33. ...
34. ...
35. ...
36. ...
37. ...
38. ...
39. ...
40. ...
41. ...
42. ...
43. ...
44. ...
45. ...
46. ...
47. ...
48. ...
49. ...
50. ...

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në Kosovë (KQZ) ka bërë me dije të enjten se 28 subjekte politike kanë aplikuar për certifikim për pjesëmarrje në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit. Në mesin e 28 subjekteve politike janë 20 parti politike, pesë

koalicione, dy iniciativa qytetare dhe një kandidat i pavarur. KQZ-ja duhet t'i konfirmojë listat më së voni deri më 25 dhjetor. Pas dorëzimit të listave kanë reaguar edhe liderët e partive. Kryetari i LV-së, Albin Kurti, e ka quajtur "Lista e fitores së madhe!",

ndërsa kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka theksuar se kanë dorëzuar listën e ekipit fitues. Edhe lideri i LDK-së, Lumir Abdullahu, edhe ai i AAK-së, Ramush Haradinaj, kanë theksuar se listat e tyre janë fituese në zgjedhjet e 9 shkurtit

AKTUALE



BULLGARIA DHE RUMANIA BËHEN ANËTARE TË PLOTA TË ZONËS SCHENGEN F. 2

ARTAN GRUBI TËRHIQET NGA POLITIKA F. 3

IPK-JA, TETË REKOMANDIME PËR PËRDORIM TË KAMERAVE TRUPORE NGA POLICIA F. 7

EKONOMI



KOSOVA PAS SHQIPËRISË PËR NIVELIN E TRANSPRENCËS BUXHETORE F. 8

ATK-JA FITON DY ÇMIME PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT F. 8

SPORT



VDES FUTBOLLISTI I VUSHTRRISË, ERJON MORINA F. 11

AUTORITETET E KOSOVËS DHE TË SHQIPËRISË SHKATËRROJNË NJË GRUP TË TRAFIKIMIT TË ARMËVE F. 3



KUVENDI I GJILANIT SHPALL 'QYTETAR NDERI' ISH-AMBASADORIN QEMAL MINXHOZI F. 5



RENOVA
Maqedoni
Xhëpçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mail: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Bullgaria dhe Rumania bëhen anëtare të plota të zonës Schengen

SOGJE, 12 DHJETOR - Vendet anëtare të Bashkimit Evropian ua kanë hapur rrugën Bullgarisë dhe Rumanisë për t'u bërë anëtare të plota të zonës për lëvizje të lirë Schengen prej fillimit të vitit tjetër. "Është moment historik që më në fund të mirëpresim Bullgarinë dhe Rumaninë", ka thënë ministri i Brendshëm i Hungarisë, Sandor Pinter, shteti i të cilit është aktualisht në krye të Presidencës së bllokut evropian. Bullgaria dhe Rumania, të dyja vende anëtare të BE-së prej vitit 2007, kanë qenë pjesërisht të integruara në zonën për lëvizje

të lirë, prej muajit mars, pasi u është mundësuar vetëm trafiku ajror dhe detar, pa kontrolle kufitare.

Austria pati refuzuar pranimin e plotë të këtyre vendeve në Schengen, duke përmendur shqetësimet rreth migrimit. Megjithatë, Vjena ka thënë të hënën se nuk do të përdorë veton në takimin e ministrave të zhvilluar mëngjesin e së enjtes, dhe kështu dy vendet do të jenë anëtare të plota prej 1 janarit të vitit 2025.

Bukureshti dhe Sofja i kanë plotësuar të gjitha kriteret teknike që u janë vendosur nga

Brukseli më 2010, mirëpo kanë pritur më shumë se një dekadë për t'u bërë pjesë e Schengenit, pasi disa vende kanë qenë kundër ndër vite.

Austria ka hequr dorë nga vetoja, vetëm pasi tri shtetet e kanë nënshkruar "pakon për mbrojtje kufitare".

Marrëveshja parasheh angazhim të përbashkët të rojeve kufitare në kufirin bullgaro-turk, dhe kontrolle të përkohshme kufitare në rrugët tokësore për periudhë gjashtëmuajore.

E krijuar më 1985, zona Schengen përbëhet prej 29



shteteve - 25 prej 27 vendeve të bllokut evropian, plus Zvicra, Norvegjia, Islanda dhe Lihtenshtajni. Kjo është zona më e madhe në

botë pa kontrolle të brendshme kufitare. Më shumë se 400 milionë njerëz mund të udhëtojnë lirshëm brenda saj.

Reporterët pa Kufij: 54 gazetarë të vrarë më 2024

PARIS, 12 DHJETOR - Këtë vit janë vrarë 54 gazetarë në botë, teksa kanë qenë duke kryer punën e tyre, apo për shkak të profesionit, është thënë në raportin vjetor të organizatës ndërkombëtare, Reporterët pa Kufij, të publikuar të enjten. Sipas organizatës, ushtria izraelite është përgjegjëse për vdekjet e 18 gazetarëve këtë vit - 16 në Gazë dhe dy në Liban. Sipas raportit, territori palestinez është më i rrezikshmi

për gazetarët, pasi atje është regjistruar shifra më e lartë e gazetarëve të vrarë në pesë vjetët e fundit.

Organizata ka thënë se ka dërguar katër kallëzime në Gjykatën Ndërkombëtare Penale për "krimet e luftës të kryera kundër gazetarëve nga ana e ushtrisë izraelite". Sipas saj, "më shumë se 145" gazetarë janë vrarë nga ushtria izraelite në Gazë, prej nisjes së luftës, në tetor të vitit 2023, dhe që 35 prej



tyre kanë qenë duke punuar në kohën kur janë vrarë.

Organizata e ka përshkruar numrin e vrasjeve si "gjakderdhje të pashembullt".

Në një raport ndaras, Federata

Ndërkombëtare e Gazetarëve (IFJ) ka thënë se 104 gazetarë janë vrarë më 2024, më shumë se gjysma e tyre në Gazë.

Shifrat e dy organizatave dallojnë, sepse ato kanë përdorur metodologji të ndryshme për t'i kalkuluar vrasjet.

Reporterët pa Kufij kanë përfshirë në listë vetëm gazetarët, për të cilët është vërtetuar se vdekja e tyre është lidhur me aktivitetin profesional.

Izraeli ka mohuar të ketë vrarë me qëllim gazetarët, por e ka pranuar se disa mund të jenë vrarë si pasojë e sulmeve ajrore.

Pas Gazës, vendi më vdekjeprurës për gazetarët më 2024 ka qenë Pakistani, më pas Bangladeshi dhe Meksika.

Deri më 1 dhjetor, 550 gazetarë janë nëpër burgje në botë, sipas Reporterëve pa Kufij.

Tri shtetet me numrin më të madh të gazetarëve të burgosur janë Kina, Mianmari dhe Izraeli.

Drejtori i FBI-së, Wray, thotë se do të japë dorëheqje para kthimit të Trumpit

WASHINGTON, 12 DHJETOR - Drejtori i Byrosë Federale amerikane të Hetimeve (FBI), Christopher Wray, ka thënë të mërkurën se do të japë dorëheqje para se presidenti i zgjedhur amerikan, Donald Trump, ta marrë detyrën muajin e ardhshëm.

Wray dha këtë njoftim gjatë një takimi të brendshëm të FBI-së të mërkurën.

Presidenti i zgjedhur Trump ka shfaqur dëshirën për ta zëvendësuar Wrayn me Kash



Patelin.

Wray, i cili ishte nominuar nga Trumpi më 2017 për të

shërbyer për një mandat 10-vjeçar, është përballur me kritika viteve të fundit nga republikanët, për shkak të hetimeve që FBI-ja i kreu ndaj Trumpit pasi ai u largua nga Shtëpia e Bardhë.

Duke dhënë dorëheqjen në vend se të presë shkarkimin, Wray po përpiqet ta shmangë ndonjë përplasje me administratën e re të Trumpit, e cila, sipas tij, do ta kishte përfshirë FBI-në "edhe më thellë në konflikt". "Qëllimi im është ta mbaj përqendrimin

te misioni ynë - që është puna e domosdoshme që ju bëni çdo ditë në emër të popullit amerikan", u tha Wray punonjësve të FBI-së. "Mendoj se kjo është mënyra më e mirë për të shmangur zhytjen e byrosë më thellë në konflikt, duke forcuar vlerat dhe parimet që janë kaq të rëndësishme për mënyrën si e kryejmë punën tonë", shtoi ai.

Trump e kishte bërë të qartë zemërimin e tij me Wrayn në disa raste.

Në një intervistë rishtazi për programin "Meet the Press" të NBC-së, Trump tha: "Nuk mund të them se jam i kënaqur me të. Ai pushtoi shtëpinë time", duke iu referuar bastisjes së FBI-së në pronën e tij në Florida, Mar-a-Lago, dy vjet më parë në lidhje me rastin e dokumenteve të klasifikuara nga mandati i tij i parë si president. Por, Wray rrallëherë dukej se përpiquej të përballë publikisht me Shtëpinë e Bardhë.

Revista 'Time' shpall Trumpin person të vitit përsëri

WASHINGTON, 12 DHJETOR - Revista 'Time' e ka shpallur presidentin e zgjedhur amerikan, Donald Trump, person të vitit për herë të dytë të enjten. Ky nderim i është bërë Trumpit pas rikthimit të tij të jashtëzakonshëm nga një ish-president që nuk e pranonte humbjen në zgjedhje katër vjet më parë, në një president të zgjedhur që i fitoi

bindshëm zgjedhjet e nëntorit për t'u kthyer në Shtëpinë e Bardhë.

Sam Jacobs, kryeredaktori i 'Time'-s, njoftoi në NBC se Trumpi është shpallur personi i vitit 2024 nga kjo revistë. Jacobs tha se Trumpi është dikush që "për të mirë apo për të keq, ka pasur më së shumti ndikim në lajme në vitin 2024". "Ai është një person që bëri rikthim

historik, i cili e ndryshoi presidencën amerikane dhe po i ndryshon politikën amerikane. Është e vështirë të argumentosh kundër faktit se personi që po kthehet në Zyrën Ovale nuk është personi më me ndikim në lajme", tha Jacobs.

Trump ishte shpallur personi i vitit për herë të parë në vitin 2016, pasi i kishte fituar

zgjedhjet presidenciale në SHBA.

Jacobs shtoi se "gjithmonë ka debat të nxehtë" në revistë për këtë çmim "edhe pse më duhet ta pranoj se këtë vit vendimi ishte më i lehtë se në vitet e kaluara".

Trump i mposhti në garë për çmimin e sivjetshëm persona të tjerë të famshëm si, nënpresidenten Kamala



Harris, pronarin e X-it, Elon Musk, kryeministrin e Izraelit, Benjamin Netanyahu, dhe Princshën e Uellsit, Kate.

Artan Grubi tërhiqet nga politika

Shkup, 12 dhjetor - Tri ditë pas futjes në listën e zezë amerikane, ish-zëvendëskryeministri i Maqedonisë së Veriut, Artan Grubi, ka njoftuar të mërkurën vonë, se ka vendosur të tërhiqet nga politika dhe jeta publike. Në një reagim përmes "Facebook"-ut, Grubi, nga radhët e Bashkimit Demokratik për Integritim (BDI), në opozitë, bëri me dije se për këtë vendim e ka

informuar edhe kryetarin e partisë së tij, Ali Ahmeti, "që nga dita e parë". "Unë, përpara Zotit, familjes dhe miqve jam i pastër si loti, por me synimin për të zbardhur të vërtetën, të cilën shumë prej jush e shoh që tashmë e dini, dhe për të mos qenë barrë politike, kam vendosur që të tërhiqem nga jeta publike dhe për këtë e kam njoftuar kryetarin Ahmeti qysh ditën e parë", shkroi Grubi. Ai theksoi, gjithashtu, se



"sulmet e mëdha ndër vite, keqinterpretimet dhe goditjet e padrejta" e kanë shtyrë të

marrë një vendim të këtillë. "Ky është një vendim i vështirë, por i nevojshëm për

të kursyer familjen dhe ruajtur integritetin tim personal dhe politik, si dhe për të mbështetur vazhdimësinë e punës dhe përkushtimit të liderit tonë, Ali Ahmeti. Besoni tek rruga e tij e drejtë, një rrugë që ka qenë dhe mbetet shpresa më e madhe për shqiptarët dhe për të gjithë qytetarët e Maqedonisë së Veriut. Unë mbetem gjithmonë i përkushtuar ndaj këtyre vlerave dhe do të jem në krah të tyre, si qytetar dhe si mbështetës i së mirës së përbashkët", ka shkruar ai.

Autoritetet e Kosovës dhe të Shqipërisë shkatërrojnë një grup për trafikim armësh

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Prokuroria Speciale e Kosovës ka bërë me dije se në bashkëpunim me autoritetet e drejtësisë në Shqipëri, kanë shkatërruar një grup kriminal të trafikimit të armëve që ka qenë aktiv në të dyja shtetet.

Pas hetimeve mbi nëntë muaj, autoritetet kanë arrestuar 14 persona të dyshuar.

Tetë persona janë arrestuar në Kosovë, gjashtë shtetas të Kosovës dhe dy shtetas të Shqipërisë, me inicialet: V. O., K. K., S. H., Sh. J., A. H., Z. A., A. D., B. A.

Gjashtë persona janë arrestuar



në Shqipëri, me inicialet E. M., E. P., A. M., G. LL., K. M. dhe T. Sh. Autoritetet e të dyja vendeve

kanë thënë se rasti është duke u hetuar dhe janë të hapura të gjitha dyshimet, përfshirë

mundësinë e trafikimit të armëve për treg ndërkombëtar apo vendor, në Kosovë dhe Shqipëri.

Pas kryerjes së kontrolleve në nëntë lokacione, Prokuroria ka bërë me dije se në Kosovë janë gjetur dhe sekuestruar 29 pistoletë, tri armë të gjata, 2 635 fishekë të modeleve të ndryshme, dy automjete dhe pajisje të tjera.

Në Shqipëri janë gjetur 22 armë zjarri "Zoraki", një armë zjarri Ak 47, një granatë dore ofensive dhe 470 fishekë të llojeve të ndryshme.

Në një konferencë për medie,

zyrtarë të Policisë së Kosovës dhe të Policisë së Shtetit të Shqipërisë kanë thënë se hetimet për këtë rast kanë nisur qysh prej prillit, pasi kanë pranuar informacione se disa njerëz janë duke u marrë me import, eksport, furnizim, transportim, ndërmjetësim dhe shitje të paautorizuar të armëve apo materialeve plasëse.

Dy vendet kanë nënshkruar marrëveshje për krijim të një ekipi të përbashkët hetimor, ndërsa në këtë operacion, të titulluar "Çmontimi", ka ndihmuar edhe Agjencia e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit (EUROPOL).

Prokuroria Speciale e fton Kurtin të dëshmojë

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është ftuar për dëshmi nga Prokuroria Speciale, ka njoftuar zëdhënësi i qeverisë, Përparim Kryeziu. Në "Facebook", Kryeziu kritikoi sistemin e drejtësisë për ndërhyrje në procesin zgjedhor. "Në zgjedhjet e kaluara kishte një vendim gjyqësor, i cili ia kishte pamundësuar [Kurtit] kandidimin në garën zgjedhore të 14 shkurtit 2021, kurse tash, përmes kësaj ftese, po tentohet ndikimi në rezultatin e zgjedhjeve të vitit 2025", shkroi ai.

"Radio Evropa e Lirë" (REL) e pyeti se për çfarë rasti bëhet

fjalë, por ai nuk u përgjigj. Prokurorët nënshkruan të thirrjes së Kurtit për të dëshmuar, Valdet Gashi dhe Milot Krasniqi, janë prokurorë specialë nga Departamenti për Hetimin e Korrupsionit dhe Krimin Financiar.

"REL"-i e ka pyetur Prokurorinë Speciale në lidhje me këtë rast, por nuk ka marrë përgjigje të menjëhershme. Sipas ftesës së prokurorëve, Kurti është thirrur të dëshmojë në një rast për një vepër penale nga neni 414 i Kodit Penal, i cili ka të bëjë me keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar.

Edhe zëvendëskryeministri i



Kosovës, Besnik Bislimi, e lidhi ftesën e prokurorëve për Kurtin me fushatën

zgjedhore. "Pse kjo nguti, i nderuar prokuror? Fushata fillon në janar", shkroi

Bislimi në "Facebook". Zgjedhjet parlamentare në Kosovë do të mbahen më 9 shkurt të vitit të ardhshëm. Në zgjedhjet paraprake më 2021, Kurti nuk iu lejua të kandidonte për deputet, pasi Gjykata Kushtetuese nxori vendim që kandidatët, të cilët në tre vjetët e fundit kishin vendim gjykate të formës së prerë, nuk mund të garojnë. Kurti kishte një dënim të tillë për shkak të trazirave që ndodhën në Kuvendin e Kosovës derisa ai ishte në opozitë. Prej që është kryeministër Kurti në disa raste e ka kritikuar sistemin e drejtësisë, duke thënë se është joefikas dhe i ngadaltë.

Gërvalla thotë se Guxo është e konsoliduar dhe unike

Prishtinë, 12 dhjetor - Bashkryetarja e partisë Guxo, Donika Gërvalla, ka bërë një sqarim rreth partisë, duke thënë se ata që nuk përfshihen në listat për deputetë, aktivizohen e zgjohen.

Ky reagim i saj vjen pas reagimit që bëri dje deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e partisë Guxo, Burim Meta dhe reagimit të Degës së Guxo-s në Pejë.

Gërvalla ka shkruar në "Facebook" se "partia Guxo dhe e gjithë struktura e saj sot është më e fortë, më e konsoliduar e më unike se kurrë". "Gjithmonë ka pasur dhe do të ketë persona, të cilët kur nuk përfshihen, për arsye të ndryshme, në listën e kandidatëve për deputetë, tek atëherë aktivizohen e zgjohen. Partia Guxo dhe e gjithë struktura e saj, dhe këtë e them

me përgjegjësinë jo vetëm të bashkëkryetares së Partisë Guxo, por edhe si kryetare e Degës së Partisë Guxo në Pejë, sot është më e fortë, më e konsoliduar e më unike se kurrë. Me listën tonë prej 15 kandidatësh, në partneritet me VV dhe Alternativën, në zgjedhjet e 9 Shkurtit do të fitojmë fuqishëm e do të vazhdojmë punët e mira për Kosovën!", ka shkruar Gërvalla.



PDK

LISTA E KANDIDATËVE PËR DEPUTETË

1 Bedri Hamza	38 Vesa Broja	75 Artan Behrami
2 Memli Krasniqi	39 Faton Abdullahu	76 Majlinda Hajrullahu
3 Vlora Çitaku	40 Genc Prelvukaj	77 Shahin Dervishaj
4 Enver Hoxhaj	41 Besa Ismaili Ahmeti	78 Vehbi Nazifi
5 Uran Ismaili	42 Nait Hasani	79 Ilir Orllati
6 Eliza Hoxha	43 Idriz Vehapi	80 Granit Berisha
7 Rrahman Rama	44 Edon Cana	81 Floriana Rugova
8 Bernard Nikaj	45 Albana Murseli	82 Adnan Thaqi
9 Sala Jashari	46 Zenun Pajaziti	83 Selver Xhelili
10 Abelard Tahiri	47 Aurorë Osmani Buca	84 Merita Makolli
11 Jakup Nura	48 Naim Ismajli	85 Faruk Bojaxhi
12 Ganimete Musliu	49 Antigona Bytyqi	86 Drita Qenaj
13 Blerita Deliu Kodra	50 Betim Gjoshi	87 Xhemshit Krasniqi
14 Xhavit Haliti	51 Petrit Hajdari	88 Patriot Krasniqi
15 Kujtim Gashi	52 Shasivar Haxhijaj	89 Fetah Paçarizi
16 Ferat Shala	53 Pleurat Sejdiu	90 Zana Këpuska
17 Elmi Reçica	54 Adonjeta Zymberi Selmani	91 Leutrim Retkoceri
18 Ariana Musliu Shoshi	55 Valon Grabovci	92 Sevdin Dornjani
19 Fadil Demaku	56 Kosovare Murseli	93 Fatime Shala
20 Altin Krasniqi	57 Fadil Millaku	94 Bashkim Mustafa
21 Mimoza Ahmetaj	58 Ramë Vataj	95 Florentina Vokshi
22 Drin Ejupi	59 Qefsere Kuçi	96 Lulzim Nika
23 Arbnore Salihu	60 Hyzer Rizani	97 Driton Lajçi
24 Arbër Behluli	61 Taulant Haxhiu	98 Agnesë Kastrati Bucolli
25 Besianë Musmurati	62 Arbiana Xhemajli	99 Isak Neziri
26 Rashit Qalaj	63 Sylejman Berisha	100 Mergim Lushtaku
27 Besa Kabashi Ramaj	64 Gresë Baralihu Halili	101 Xhafer Preteni
28 Arben Mustafa	65 Ardian Kastrati	102 Arta Nallbani
29 Përparim Gruda	66 Hava Mlinaku	103 Qëndrim Qerimi
30 Kristina Gashi Bytyqi	67 Hisen Berisha	104 Ilir Tahiri
31 Hajdar Beqa	68 Aurora Berisha	105 Igballe Asllani Potera
32 Isak Shabani	69 Fatbardh Rexha	106 Shaip Shabani
33 Floretë Zejnullahu	70 Mevludin Mazreku	107 Burim Januzi
34 Ragip Xhaka	71 Sabri Murseli	108 Zojë Hajrizi
35 Xhevahir Geci	72 Mimoza Pajaziti	109 Bekim Haxhiu
36 Valdete Idrizi Deskaj	73 Aulonë Sylja	110 Iliric Musliu
37 Kurtan Kajtazi	74 Azem Guri	

#MaMirë

LDK

LISTA E KANDIDATËVE PËR DEPUTETË

1 LUMIR ABDIXHIKU	51 MIRLINDA KRASNIQI
2 KUJTIM SHALA	52 FETAH RUDI
3 DOARSA KICA XHELILI	53 FATMIR KASTRATI
4 LUTFI HAZIRI	54 KIMETE KUKA HASALLARI
5 GAZMEND MUHAXHERI	55 SHKELZEN HAJDINI
6 HYKMETE BAJRAMI	56 RASIM HASANI
7 IMRI AHMETI	57 ANILA REÇICA LLUGIÇI
8 SOKOL HALITI	58 ARDIAN OLLURI
9 JEHONA LUSHAKU SADRIU	59 KASTRIOT SHABANI
10 ANTON QUNI	60 XHENET SYKA KELMENDI
11 XHAFER GASHI	61 FATMIR ASLLANI
12 SIBEL HALIMI	62 SADRI BERISHA
13 AVDULLAH HOTI	63 ALBULENA MUJAJ BAJRAKTARI
14 ARBEN GASHI	64 REXHEP KURTBOGAJ
15 DORUNTINE MALOKU	65 ARBEN LIMANAJ
16 EKREM HYSENI	66 LENDITA BEKTESHI
17 ARMEND ZEMAJ	67 AVDYLL ALIU
18 LIRIJE KAJTAZI	68 BARDHYL SYLA
19 VISAR AZEMI	69 FIKNETE BEJTA
20 BERAT RUKIÇI	70 BESIM GUDA
21 VALENTINA BUNJAKU REXHEPI	71 VALON DEMOLLI
22 BESIAN MUSTAFA	72 ARJETA SALIHU ABAZI
23 ARDIAN SHALA	73 QENDRIM SOFTOLLI
24 DRITA MILLAKU	74 FEHMI ZEQIRI
25 XHAFER TAHIRI	75 FATLUME JAHA
26 DRITON SELMANAJ	76 MUSTAF ABASI
27 BESA GAXHERRI	77 LUMBARDH SALIHU
28 ALBAN ZOGAJ	78 SERBEZE KABASHI MUÇAJ
29 SHKEMB MANAJ	79 BESIM MULAJ
30 VLORA DUMOSHI	80 HYSEN ÇEKAJ
31 SHEFQET SHEHU	81 SARANDA MUSLIU
32 KRENAR XHAFERI	82 RAMADUSH EMINI
33 MARIQONA GECI	83 ZEQIR GJUKAJ
34 FLORIAN DUSHI	84 LISA RUGOVAJ
35 IZET SADIKU	85 ARIJANA QAFLESHI
36 RREZARTA KRASNIQI	86 QAMIL KOLLONI
37 FADIL HADERGJONAJ	87 XHYLFE RIJE BAHTJARI BEQIRI
38 ALBAN RRACI	88 URIM SUKA
39 ELMIRE NIKCI REXHA	89 SHAQIR KRYEZIU
40 SOKOL HAVOLLI	90 SHEMSIJE BYTYÇI
41 LULZIM ZHEGROVA	91 SELMAN KOLGECI
42 DONJETA DRAGUSHA	92 LAUREAT GOJNOVCI
43 GEZIM PLAKOLLI	93 SEVDIJE LAMA
44 FATMIR ADEMAJ	94 VALON BELLANICA
45 JETA RAFUNA HASANI	95 MUHARREM KURTI
46 ZEF MORINA	96 AJLIN SHISHKO
47 ISMET BEQIRI	97 XHAVIT UKA
48 VJOLLCA ZEJNULLAHU	98 SHABAN OSMANAJ
49 NUREDIN IBISHI	99 BAHRIJE HYSENI
50 FADIL ALIU	100 BAJRUSH YMERI
	101 JETON BIQKAJ
	102 EGZONA ZUZAKU ISUFI
	103 KORAB KRASNIQI
	104 FATBARDHA ISTREFI AVDIU
	105 ANITA MORINA SARAÇI
	106 BASHKIM GASHI
	107 ENIS DURGUTI
	108 IBADETE MEHMETI
	109 DEMOKRAT GANIJAJ
	110 PARIS GURI

bëhu ndryshimi

PARTITË POLITIKE KANË DORËZUAR LISTAT E KANDIDATËVE PËR DEPUTETË NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE NË KOSOVË

Partitë dorëzojnë listat për deputetë, brohorasin për fitore më 9 shkurt

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në Kosovë (KQZ) ka bërë me dije të enjten se 28 subjekte politike kanë aplikuar për certifikim për pjesëmarrje në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit. Në mesin e 28 subjekteve politike janë 20 parti politike, pesë koalicione, dy iniciativa qytetare dhe një kandidat i pavarur. KQZ-ja duhet t'i konfirmojë listat më së voni deri më 25 dhjetor. Pas dorëzimit të listave kanë reaguar edhe liderët e partive. Kryetari i LV-së, Albin Kurti, e ka quajtur "Lista e fitores së madhe!", ndërsa kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka theksuar se kanë dorëzuar listën e ekipit fitues. Edhe lideri i LDK-së, Lumir Abdixhiku, edhe ai i AAK-së, Ramush Haradinaj, kanë theksuar se listat e tyre janë fituese në zgjedhjet e 9 shkurtit

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në Kosovë (KQZ) ka bërë me dije të enjten se 28 subjekte politike kanë aplikuar për certifikim për pjesëmarrje në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit. Sipas një njoftimi për medie, pas mbylljes së afatit zyrtar, në mesin e 28 subjekteve politike janë 20 parti politike, pesë koalicione, dy iniciativa qytetare dhe një kandidat i pavarur. Në mesin e subjekteve janë parti shqiptare, të komunitetit serb dhe të komuniteteve të tjera më të vogla në Kosovë. Valmir Elezi nga KQZ-ja ka thënë

se institucioni të cilit i përket do të bashkëpunojë me autoritetet kompetente për t'i bërë verifikimet lidhur me përshtatshmërinë apo aftësinë e kandidatëve për t'u certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje. Ai ka thënë se ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që t'ia dërgojë KQZ-së emrat e kandidatëve që janë të dënuar në tre vjetët e fundit me vendim gjyqësor të formës së prerë për veprë penale. "Neni 30 parasheh disa raste se kur një person nuk mund të certifikohet kandidat për deputet. Në këtë nen parashihet se një person nuk mund të certifikohet si kandidat, nëse është i dënuar në tre vjetët e fundit me vendim gjyqësor të

formës së prerë për veprë penale me një ose më shumë vjet burgim efektiv", është shprehur ai. KQZ-ja duhet t'i konfirmojë listat më së voni deri më 25 dhjetor. Zëdhënësi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Valmir Elezi, ka thënë se do të kërkojnë nga institucionet kompetente t'i bëjnë verifikimet e nevojshme sa iu përket kandidatëve për deputetë. Ai ka thënë se kanë kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që t'ua dërgojnë emrat që janë të dënuar në tri vitet e fundit me vendim gjyqësor të formës së prerë me një ose më shumë vjet burgim efektiv. Elezi ka bërë me dije se KQZ-ja

ka një kërkesë edhe nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa. "Gjithashtu ky nen (30) specifikon që kandidat nuk mund të certifikohet një person i cili është zyrtar i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa; me anë të vendimit të gjykatës, përfshirë edhe vendimin e PZAP-it, i është hequr e drejta për të qenë kandidat; ka dështuar të paguajë gjobën e vënë nga PZAP-i, apo KQZ-ja; ose ka dështuar t'i përmbahet ndonjë urdhri të PZAP-it. Prandaj, kemi kërkuar nga PZAP-i të bëjë verifikimet në raport me këto kufizime ligjore", ka theksuar Elezi. Pas dorëzimit të listave kanë reaguar edhe liderët e partive. Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka theksuar se "e dorëzuar listën e fitores së madhe!". Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, derisa ka paraqitur listën e kandidatëve të PDK-së për deputetë për zgjedhjet e përgjithshme të 9 shkurtit, ka theksuar se lista e PDK-së nuk paraqet vetëm emra, por një ekip fitues me vizion për të ardhmen, të përkushtuar për një Kosovë më të mirë. "Mbi 50 % e listës së

kandidatëve tanë janë pjesë e garës për herë të parë, duke sjell energji dhe ide të reja në misionin tonë. Dua t'i shpreh falënderimet e mia më të sinqerta për të gjithë ata që janë pjesë e kësaj liste dhe për ata që kanë shprehur gatishmërinë për të kontribuar, qoftë edhe në mënyra të tjera të rëndësishme", ka thënë Krasniqi. Ai ka shtuar se suksesi i PDK-së në zgjedhjet e 9 shkurtit është i garantuar me këtë listë të prirë nga kandidati për kryeministër, Bedri Hamza. "Përkushtimi dhe mbështetja juaj janë të pazëvendësueshme për Partinë Demokratike të Kosovës. Urime të gjithë kandidatëve tanë! Duke mbështetur njëri-tjetrin dhe të prirë nga kandidati ynë për kryeministër, Bedri Hamza, suksesi ynë është i garantuar. Faleminderit, dhe le ta fitojmë këtë betejë së bashku!", ka thënë Krasniqi. Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka thënë se lista e tyre është fituese e zgjedhjeve të 9 shkurtit. "Lista fituese e zgjedhjeve të 9 shkurtit", ka shkruar Abdixhiku në "Facebook". Ndërkaq kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush

Osmani shkon në Uashington, takohet me senatorin republikan Thom Tillis

WASHINGTON, 12 DHJETOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ndodhet për vizitë zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA). Ajo ka njoftuar se të enjten është takuar me senatorin republikan Thom Tillis. Me këtë rast, Osmani ka thënë se "paqja dhe siguria e qëndrueshme janë parakushte për prosperitet e zhvillim ku ShBA-ja ka qenë dhe mbetet e përkushtuar për të

ndihmuar për t'i ruajtur dhe avancuar ato në Kosovë". "Jemi në Washington D. C. për takime në Senat e në Dhomën e Përfaqësuesve, para se të vazhdojmë për Rhode Island ku do të mbajë fjalimin kryesor në Simpoziumin 11 Vjetor të 'United States Naval War College'. Kënaqësi të takohem sot me senatorin republikan Thom Tillis me të cilin diskutuam për zhvillimet e fundit të

sigurisë në Kosovë e në Ballkanin Perëndimor, si dhe për rëndësinë e bashkëpunimit drejt ruajtjes së paqes dhe sigurisë në rajonin tonë. Paqja dhe siguria e qëndrueshme janë parakushte për prosperitet e zhvillim. ShBA-ja ka qenë dhe mbetet e përkushtuar për të ndihmuar, ruajtur dhe avancuar ato në Kosovë", ka shkruar Osmani në "Facebook".



LISTA E KANDIDATËVE PËR DEPUTETË

#Kurti3

ALBIN KURTI KRYEMINISTËR

1. ALBIN KURTI	38. ARIJETA REXHEPI	75. MIRLINDA TISHUKAJ SADIKU
2. GLAUK KONJUFCA	39. ARDIAN GOLA	76. BAJRAM MAVRIQI
3. DONIKA GËRVALLA SCHWARZ	40. ARSIM ADEMI	77. IMRI DEMELEZI
4. AVNI DEHARI	41. MIRSAD SHKRETA	78. SIBORA KADRIU
5. ALBULENA HAXHIU	42. ALBENA RESHITAJ	79. VLORA LIMANI HAJNUNI
6. HEKURAN MURATI	43. DIJANA QARKAXHIJA	80. BURIM DEMIRI
7. XHELAL SVECLA	44. JETON RAKA	81. AGIM BAHTRI
8. MIMOZA KUSARI LILA	45. ZEF NDRREJAJ	82. DAFINA ALISHANI
9. FATON PEÇI	46. ARJETA FEJZA	83. BESIM MUZAJI
10. SHOPIE MEHMETI SELIMI	47. NEZIR KRAKI	84. SYLEJMAN MEHOLLI
11. SARANDA BOGUJEVCI	48. MEFAIL BAJJOINOVCI	85. ENVER HALITI
12. ARBEN VITIA	49. DRITON HYSANI	86. ARBRESHA MEHA
13. HAJRULLA ÇEKU	50. ADRIANA MATOSHI	87. ENVER DUGOLLI
14. ARBERIE NAGAVCI	51. LIZA GASHI	88. GRAMOS AGUSHOLLI
15. ARTANE RIZVANOLLI	52. RAIF ÇAVOLLI	89. NASUF BEJTA
16. ROZETA HAJDARI	53. LEONORA SHABANI BAJRAKTARI	90. SHOPIE ISUFI
17. EJUP MAQEDONCI	54. HYDAJET HYSANI KALOSHI	91. ISMAJL KURTESHI
18. FATMIRE KOLLÇAKU	55. SANIJE REXHA	92. NORA FETOSHI
19. EDONA LLALLOSHI	56. VALON RAMADANI	93. ILIR GASHI
20. ARMEND MUJA	57. SHPËTIM HAJDARAJ	94. TEUTA MULAJ
21. HAXHI AVDYLI	58. TAULANT KEMENDI	95. SHPEN BARDIQI
22. DIMAL BASHA	59. JETMIRE VRENEZI	96. GAZMIR RACI
23. FITORE PACOLLI DALIPI	60. HYSEN DURMISHI	97. SHUAJB BLAKÇORI
24. AGON DOBRUNA	61. MENTOR ARIFAJ	98. FJOLLA UJKANI
25. HYSAMEDIN FERAJ	62. VIGAN QORROLLI	99. MILAZIM SALLJAJ
26. JETA STATOVCI	63. HASIME TAHIRI HASANI	100. VALON HOTI
27. GANI KRASNIQI	64. LUAN ALIU	101. HAMDİ JAHA
28. ARBËRESHË KRYEZIU HYSANI	65. HALIL THAÇI	102. EGZONA TËRDEVCI
29. ARBËR REXHAJ	66. TRIERA KASUMI BERISHA	103. DRITA PAJAZITI
30. ADNAN RRUSTEMI	67. LABINOTË DEMI MURTEZI	104. JETMIR AJDINI
31. BLERIM GASHANI	68. ILIR KËRÇELI	105. BASRI HYSANI
32. BYLBYL SOKOLI	69. VENDORIS LAHU	106. GEGË LLESHI
33. DAULINA OSMANI	70. ADELINA GRAINCA	107. ALBAN BAJRAMI
34. ARTAN ABRASHI	71. LUAN GACAFERI	108. BRUNILDA GJURA
35. MYTHER HASKUKA	72. NIJAZI ISAKU	109. FATBARDHA REKA
36. DAFINA GEXHA BUNJAKU	73. FITIM HAZIRI	110. SALIH ZYBA
37. LENDRIT ILJAZI	74. AGON BATUSHA	

NA PRIFTË E MBARA!

Haradinaj, ka thënë se lista që kanë dorëzuar është listë e fitores. "Lista e Kosovës fituese", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Zgjedhjet e 9 shkurtit do të jenë zgjedhjet e para të rregullta

parlamentare që do të organizohen në Kosovë që nga shpallja e pavarësisë më 2008. Për një kohë të gjatë partitë opozitare kishin kërkuar mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme, por më herët

gjatë këtij viti dështuan të arrinin pajtim se si të shkohet në zgjedhje.

Në fund të majit dështoi një nismë e subjektit më të madh opozitar, Partia Demokratike e Kosovës, që në zgjedhje të shkohet përmes shpërndarjes së Kuvendit. Kjo mundësi u kundërshtua nga dy partitë e tjera opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, të cilat kërkuar që qeveria e udhëhequr nga Albin Kurti të jepte dorëheqje apo të shkarkohej. Por, këto dy kërkesa u kundërshtuan nga Lëvizja Vetëvendosje e Kurtit.

Lista e publikuar nga KQZ-ja

Parti politike: Lëvizja Vetëvendosje!, Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës, Srpska Lista, Srpski Narodni Pokret, Fjala, Partia Liberale Egjiptiane, Nova Demokratska Stranka, Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës, Socialdemokratska Unija, Kosova Demokratik Türk Partisi, Yenilikçi Türk Hareket Partisi, Jednstvena Goranka Partija (JGP), Partia e Ashkalinjëve për Integrim (Pai),

Srpska Demokratija, Partija Kosovskih Srba, Za Slobodu Pravdu i Postanak, Partia Balli Kombëtar Demokrat Shqiptar, Partia Rome e Bashkuar e Kosovës, Kosova Adalet Türk Partisi.

Koalicione: Naša Bošnjačka Koalicija (Naša Inicijativa i Bošnjačka stranka), AAK - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Nisma - Nisma Socialdemokrate, Lista Konservatore, Forumi intelektual - E-30, Koalicioni për Familje, PDAK-LPB, Koalicija Vakut. Nisma Qytetare: Narodna Pravda, Opre Roma Kosova.

Kandidat i pavarur: Fatmir Bytyqi.

AAK - ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS	NISMA NISMA - NISMA SOCIALDEMOKRATE
1 RAMUSH HARADINAJ	57 UKË BLAKAJ
2 FATMIR LIMAJ	58 VELI BYTYQI
3 TIME KADRILAJ	59 VIL'DANE LATIFI
4 ARDIAN GJINI	60 AHMET ISUFI
5 NUREDDIN LUSHTAKU	61 BESNIK BERISHA
6 ALBANA BYTYQI	62 ADEA ROKA
7 PAL LEKAJ	63 NAZIM GAGICA
8 BEKË BERISHA	64 LEJLA GASHI
9 XHEVAHIRE IZMAKU	65 ILIR TASHOLLI
10 BESNIK TAHIRI	66 FATON JAKUPI
11 GANI BAJRAKTARI	67 AGIM ÇAKA
12 DIELLZA KUKAJ	68 HAFIZE SALLAHI
13 SARANDA SALLTEKU	69 DAUT HARADINAJ
14 ZAFIR BERISHA	70 HAMDİ KOMONI
15 BALI MUHARREMAJ	71 MENSUT ADEMI
16 SMAJL LATIFI	72 QAZIM NIMANI
17 ZENUN ELEZAJ	73 LAVDIJE DELIU
18 ARBËRESHË KRASNIQI	74 BASHKIM RAMOSAJ
19 SHEMSEDIN DRESHAJ	75 SHERIF KRASNIQI
20 VESEL KRASNIQI	76 GANIMETE HAVOLLI
21 TEUTA HAXHIU	77 ERANDA BAÇI
22 ENDRIT SHALLA	78 MURTEZ ZEKOLLI
23 ALI BERISHA	79 EGZON KEMENDI
24 BURBUQE BAKIJA DEVA	80 AVNI ALIDEMAJ
25 ARTAN NIMANI	81 NEXHMEDIN SEJDIU
26 XHAVIT ZARIQI	82 SHUKRIJE BERISHA
27 JEHONA RRAFSHI LUMI	83 LULJETE BERISHA
28 KYMETE BAJRAKTARI	84 XHEMAJL HASANI
29 ISNI KILAJ	85 KUSHTRIM XHEMAILI
30 AVDULLAH KLINAKU	86 ARDIAN RAMA
31 MUHAMET MUJAJ	87 BURIM UGZMAJLI
32 FATMIR MATOSHI	88 EMRIJE BASHOTA
33 MARQE SELMANAJ	89 BRAHIM MEHMETAJ
34 ARBER TOLAJ	90 AFRIM DINA
35 ARTON DEMHASAJ	91 VENERA BOGUJEVCI
36 AGNESHA HAJREDINI	
	75 EMINE DACI ZEJNULLAHI
	76 NAIM GJOSHI
	77 ARIF AHMETI XHEKAJ
	78 MENSUR NEZIRI
	79 BESNIK KRASNIQI
	80 AHMET ISUFI
	81 AGIM PRENIQI
	82 GAZMEND SYLA
	83 ALBANA GËRXHALIU
	84 SAMIR BYTYQI
	85 FATMIR GASHI
	86 ZARIFE ASLLANI
	87 HAXHI IBISHI
	88 ARMEND MEMQAJ
	89 GENTIANA GASHI PEPAJ
	90 SAHIT SURDULLI
	91 FITORE GËRXHALIU DOLAK
	92 LAHI BRAHIMAJ
	93 LABINOT BILSIMI
	94 BURIM HASANI
	95 VALBONE BERISHA
	96 DRITON MALIQAJ
	97 MENSUR SELIMAJ
	98 DORENTINA MUSTAFA
	99 LORA LECI
	100 EDMOND HOXHA
	101 AGRON KUÇI
	102 HAKI ABAZI
	103 RRAHIM AJETI
	104 KALTRINA KRASNIQI
	105 ENGJELL KOLIQI
	106 ARBËR FAZLIU
	107 LIRIKA PACOLLI
	108 ANITA BAJRAMI
	109 ABDYLNASER SEFA
	110 FRASHER BRAHIMAJ
	111 RAMUSH AHMETAJ
	112 RASIM SELMANAJ

Kuvendi i Gjilanit shpall "Qytetar Nderi" ish-ambasadorin Qemal Minxhozi

GJILAN, 12 DHJETOR - Kuvendi i komunës së Gjilanit, nën udhëheqjen e Kushtrim Kadriut, kryesues, në seancën e së enjtes ka shpallur "Qytetar Nderi" ish-ambasadorin e Republikës së Shqipërisë, Qemal Mixhozi, në shenjë nderimi për bashkëpunimin shumëvjeçarë.

Avdyll Aliu, shef i grupit të këshilltarëve të LDK-së, tha se ka propozuar në emër të grupit politik që t'i jepet ky çmim ambasadorit Minxhozi, për kontributin e shquar për forcimin e lidhjeve në mes të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, veçanërisht me komunën e Gjilanit.

Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, tha se ky titull për ambasadorin Minxhozi është shprehje e respektit më të lartë që qyteti ynë mund t'i japë një individi, si vlerësim për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në të mirë të komunitetit, por edhe për ndihmën e tij në forcimin e lidhjeve që na bashkojnë dy vendet. "Ky titull jepet për kontributin e tij të palodhur në forcimin, përmirësimin dhe thellimin e marrëdhënies në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, dy shtete që ndajnë një komb e që kanë një histori dhe një të ardhme të përbashkët", ka Hyseni. Ndërkaq, ish-kryetari i



komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, tha se Kuvendi Komunal sot po e nderon një personalitet, i cili me misionin e tij diplomatik bëri që kjo komunë ta ketë respektin dhe

kujdesin e Tiranës. Ambasadori Qemal Minxhozi ka shprehur falënderime për nderin që i është bërë nga kuvendarët e Gjilanit. "Gjilani do ta quajë një vend

historik, shumë të rëndësishëm jo vetëm për trevën e Anamoravës, por për kombin shqiptar. Ka rënë në thella në shtetformimin, historinë, trimërinë dhe në përballjen me çdo armik. Gjilani është një zonë e dijes, që përfaqëson në mënyrë sa më të dinjitetshme të gjitha përpjekjet e luftës për liri e pavarësi dhe e përkthyer në kohë e sotme, me aktivitetet fantastike të 'Flakës së Janarit', është shprehur Minxhozi.

Në këtë ceremoni ka mbajtur një fjalë rasti edhe ambasadori aktual i Republikës së Shqipërisë, shkëlqesia e tij, Petrit Malaj.

'Si skllave', punëtoret filipine në Kosovë durojnë abuzimet në heshtje

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Të mashtruara nga agjenci të rekrutimit me ëndrra për një jetë më të mirë, shumë punëtore filipine të përkujdesjes shtëpiake në Kosovë përballen me një realitet të ashpër. Disa prej tyre, të lëna pa dokumente, i durojnë abuzimet në heshtje, të bllokuara nga kontratat që nuk mund t'i lexojnë dhe nga një sistem që nuk arrin t'i mbrojë.

Me pasaportën e konfiskuar, një punëtore filipine pastron shtëpinë e punëdhënësit të saj në Kosovë dhe kujdeset për fëmijët e tij nga momenti kur hap sytë në mëngjes e deri kur i mbyll në orët e vona të mbrëmjes.

Për gjashtë ditë në javë Laura duron edhe dhunën e ushtruar nga njëri fëmijë i punëdhënësit. "Vetë shefi e ka parë duke më goditur. I ka folur atij dhe fëmija ka thënë se nuk do ta përsërisë, por prapëseprapë e bën", thotë ajo për Radion Evropa e Lirë.

Laura ka më shumë se një vit që punon në Kosovë, e sjellë nga një agjenci për rekrutim të punëtorëve të huaj në Shqipëri.

Nga Shqipëria, me veturën e punëtorit të agjencisë, ajo ka udhëtuar për në Kosovë pa u pajisur me vizë, leje qëndrimi apo leje pune. "Ata [në kufi] nuk shikuan... nuk inspektuan. Thjesht, më lanë të kaloja. Agjenti më sollti këtu dhe e takova punëdhënësin diku pranë Prizrenit", tregon ajo.

Kufiri që ndan Kosovën dhe Shqipërinë nuk kontrollohet si kufijtë e tjerë. Që nga maji i këtij viti është në fuqi një marrëveshje që lejon kalimin e tij pa kontrollim të pasaportave dhe letërnjoftimeve për shtetasit e dy vendeve.

Radio Evropa e Lirë ka pyetur Ministrinë e Punëve të Brendshme të Kosovës dhe Shqipërisë për këtë temë, por nuk ka marrë përgjigje.

Ndërkohë, Policia e Kosovës thotë se kufiri me Shqipërinë mbikëqyret në mënyra alternative, si monitorimi përmes sistemit të kamerave, informatave që pranon Policia Kufitare nga institucionet e sigurisë, patrullimeve në brezin kufitar etj.

Drejtorja për Migrim dhe të Huaj në Policinë e Kosovës gjithashtu thotë se bën rregullisht inspektime të kompanive që dyshohet se punësojnë punëtorë të huaj. Kontrata e Laurës përcakton se ajo do të punojë 40 orë në javë për një kompani. Megjithatë, kontrata nuk e reflekton realitetin e saj të punës.

Laura jeton e punon deri në 16 orë në ditë në shtëpinë ku është e punësuar si shtëpiake. Kjo bën që respektimi i të drejtave të saj si punëtore të mos monitorohet nga askush, pasi që Inspektorati i Punës në Kosovë nuk ka mandat të kontrollojë në shtëpi private. Brikenë Hoxha, drejtoreshë e



Iniciativës Kosovare për Stabilitet (IKS), thotë se punëtorët si Laura nënshkruajnë kontrata me pronarë biznesesh kinse do të punojnë në atë biznes, por realisht punojnë në shtëpitë e tyre. "Ky punësim është plotësisht joformal dhe kushtet natyrisht që nuk janë ashtu siç do të ishin po të pajiseshin me kontratë reale", thotë Hoxha për Radion Evropa e Lirë.

REL-i ka pyetur Inspektoratin e Punës - për të cilin ka marrë vesh se është në dijeni për keqpërdorimet e punëdhënësve me punëtorët e kujdesit shtëpiake - por nuk ka marrë asnjë përgjigje.

Kontakti mes punëtoreve filipine dhe punëdhënësve të tyre në Kosovë arrihet përmes ndërmjetësimit të agjencive të rekrutimit, kryesisht nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut.

Brikenë Hoxha, nga IKS-i - që monitoron tash e sa muaj kushtet e punës për imigrantët - thotë se më problematike është gjendja e atyre që vijnë përmes Shqipërisë.

Me gjithë tentimet, agjenci të rekrutimit në Shqipëri s'kanë qenë të qasshme për t'u përgjigjur në pyetjet e REL-it për këtë temë.

Ekspertja e punësimit në Shqipëri, Kumrie Zika, thotë se këto agjenci nuk i respektojnë procedurat e rekrutimit të drejtë. "Synimi i tyre është vetëm fitimi i të ardhurave dhe patjetër që punëtorët imigrantë i shohin si dikë që mund ta këmbëjnë në cilëndo vlerë, pa ndjekur asnjë procedurë", thotë Zika për REL-in.

Shqipëria ka nënshkruar së fundi një marrëveshje me Organizatën Ndërkombëtare të Punës (ILO), e cila parasheh që agjencitë nuk mund t'u kërkojnë para punëtorëve imigrantë për gjetjen e një vendi pune, pasi që këtë shpenzim parashihet ta mbulojnë punëdhënësit.

Megjithatë, KENZA Dimechkie, nga ILO-ja, tregon për Radion Evropa e Lirë se ky rregull, shpeshherë, nuk zbatohet. "Ne kemi agjenci rekrutimi në Shqipëri, të cilat rekrutojnë njerëz që mbase tashmë janë duke punuar në një vend të Gjirit ose ndonjë vend tjetër në

Azi dhe ata vijnë në Shqipëri e pastaj dërgohen në Kosovë", thotë ajo. "Kështu që, ata kalojnë nëpër disa ndërmjetësues të ndryshëm, që mund t'u kërkojnë para. Dhe, këto shuma grumbullohen dhe mund t'i fusin në borxhe punëtorët, gjë që pastaj ua bën të vështirë ta lënë vendin e punës", shton ajo.

Sipas Dimechkie, një hap drejt zgjidhjes së këtyre problemeve do të ishte monitorim strikt i punës së agjencive të rekrutimit, për t'u siguruar se ato i respektojnë të drejtat e punëtorëve.

Zika thotë se në Shqipëri nuk bëhen mjaftueshëm kontrole ndaj këtyre agjencive, "sepse po të bëheshin mjaftueshëm, do të ishin reduktuar këto raste".

E, në mungesë të një mbrojtjeje institucionale - si në Shqipëri, ashtu edhe në Kosovë - një grup prej 53 punëtoreve filipine në Kosovë së fundi janë bërë bashkë, në përpjekje për ta formuar një organizatë joqeveritare.

Radio Evropa e Lirë ka ndjekur një takim të tyre, ku ato kanë rrëfyer problemet e shumta me të cilat përballen.

Ato s'ishin të gatshme t'i ndanin publikisht ato, pasi frikësoheshin nga punëdhënësit, të cilët i quanin "njerëz të fuqishëm" në Kosovë.

Njëra nga themelueset, Sandra, tregon se shumica e punëtoreve filipine në Kosovë punojnë në përkujdes shtëpiake.

Për punë deri në 16 orë në ditë dhe gjashtë ditë në javë, ajo tregon se këto punëtore paguhet me nga së paku 500 euro në muaj. "Ato jetojnë falas në shtëpitë e punëdhënësit dhe ushqehen aty falas. Por, nuk mund të themi që është mjaftueshëm, sepse të punosh për 16 apo 18 orë në ditë, me një pagë fikse, është realisht e vështirë", thotë Sandra.

Ajo thekson se organizata të cilën synojnë ta themelojnë, do t'i mbështesë të drejtat e të gjithë punëtorëve imigrantë në Kosovë, jo vetëm ata filipinë. Në vitet e fundit, punëtorë të tillë ka pasur gjithnjë e më shumë në Kosovë, pasi kompanitë kanë bërë përpjekje

t'i zëvendësojnë punëtorët kosovarë që ikin drejt vendeve të Perëndimit.

Të dhënat e Ministrisë së Punëve të Brendshme tregojnë se shumica e punëtorëve vijnë nga Turqia dhe Bangladeshi - të punësuar në sektorë si ndërtimtaria e gastronomia - por, në dy vjetët e fundit, është rritur ndjeshëm edhe numri i punëtorëve nga Filipinet - shtet në Azinë juglindore.

Për punëtorët nga Filipinet, situata cilësohet si veçanërisht e vështirë, pasi që Filipinet dhe Kosova nuk kanë asnjë marrëdhënie diplomatike.

Filipinet, madje, nuk e njohin pavarësinë e Kosovës. "Në Kosovë nuk ka ndonjë konsullatë, ku ato do të mund t'i adresonin problemet e tyre. Konsullata më e afërt është në Shqipëri dhe në Maqedoni [të Veriut]. Mirëpo, meqë janë në Kosovë pa dokumentacion, është e pamundur të shkojnë në mënyrë të ligjshme dhe t'i shfaqin problemet", thotë Hoxha nga IKS-i.

Në mungesë të marrëdhënieve bilaterale, filipinëve u duhet të paktën vizë turistike për të hyrë në Kosovë.

Përballë rrezikut të jetesës pa dokumente, shumë filipinë tashmë kanë fituar leje qëndrimi në Kosovë.

Sipas të dhënave të fundit nga Ministria e Punëve të Brendshme, nga shtatori i këtij viti janë 33 filipine që kanë marrë leje për punë.

Por, Laura ka qëndruar gati një vit në Kosovë pa u pajisur me asnjë lloj dokumenti - as vizë, as leje qëndrimi e as vizë pune. Kështu, për disa muaj radhazi, ajo kishte frikë të dilte jashtë mureve të shtëpisë ku punonte edhe në ditën e vetme të javës që e kishte të lirë. "Isha shumë e frikësuar të dilja diku. Frikësohesha se policia do të më kapte. Atëherë, i thashë punëdhënësit se nuk mund të punoj në paqe këtu pa m'i bërë gati dokumentet", thotë Laura, të cilës më vonë iu nisën procedurat për marrjen e lejes së qëndrimit.

Edhe Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës është njoftuar për këto probleme. Por, e pyetur nga REL-i, kjo ministri e kaloi përgjegjësinë për këtë temë te Policia e Kosovës dhe Inspektorati i Punës.

Për të marrë leje qëndrimi, Laura do të duhej që, sipas ligjit, të largohej fillimisht nga Kosova, e pastaj ta niste procedurën e aplikimit nga fillimi. Por, kjo gjë nuk ka ndodhur në rastin e saj.

Ligji, gjithashtu, parasheh që punëtori ta ketë kontratën e punës në një gjuhë që e kupton. As kjo nuk ka ndodhur në rastin e Laurës. "Hera e parë që pashë kontratën në anglisht, ishte kur aplikua për leje qëndrimi. Unë e kërkoja një kopje, por mua ma dhanë vetëm në shqip. A kishte dallim prej asaj që u ishte dhënë institucioneve? Nuk e di, sepse nuk e kuptoja kontratën që mu dha", thotë ajo.

Gjatë kohës sa punëtoret qëndrojnë pa leje qëndrimi në Kosovë, ato janë të varura për qëndrim nga punëdhënësit e tyre. "Ata u thonë se nëse nuk do të punosh për mua, unë do të bëj gjithçka që të mos jetosh më në Kosovë, do të të kthej në vendlindjen tënde", tregon Sandra.

Sandra është ndër të paktat filipine në Kosovë që nuk jeton në shtëpinë e punëdhënësit.

Në disa raste, për t'u siguruar që punëtorët nuk do të largohen drejt vendeve të tjera, punëdhënësit i mbajnë edhe pasaportat e tyre, si në rastin e Laurës. "Mua më duhet pasaporta, sepse më duhet të dërgoj para në Filipine. Por, s'ma japin. Shefi e detyronte një punëtor tjetër të kompanisë së tij të vinte në bankë me mua dhe t'i dërgonte paratë te familja ime", thotë Laura.

Teksa ka dëgjuar rrëfime të tilla, Brikenë Hoxha ka shqyrtuar opsionet për t'u dhënë fund atyre abuzimeve.

Për të, ndryshimi duhet të nisë me një ligj të ri të punës.

Ligji aktual është miratuar në vitin 2010 dhe që nga ajo kohë ka pasur vazhdimisht thirrje për ndryshim.

Por, me gjithë kritikën dhe premtimet, ndryshimi i këtij ligji nuk u përfshi në agjendën legjislativë për vitin 2024. "Është kërkesë e shoqërisë civile që të ndryshohen këto ligje tash e sa kohë. Unë po shpresoj që institucionet do ta marrin më seriozisht dhe nuk do ta lënë këtë eksploatim të punëtorëve dhe trajtim të tyre si skllavër", thotë Hoxha.

Në mungesë të pagave të mira dhe mundësive për punë, mbi dy milionë filipinë thuhet se punojnë jashtë vendit. Paratë e fituara dërgohen në masë të madhe për familjarët e tyre në vendlindje.

Remitentat atje arrijnë mbi 40 miliardë dollarë në vit.

Me gjithë abuzimet, shumë nga punëtoret filipine në Kosovë thonë se duan të vazhdojnë të jetojnë dhe punojnë në vend. Por, shtojnë se po luftojnë për kushte të denja pune. "Edhe nëse nuk e njeh dikë në rrugë... ata thjesht të buzëqeshin. Kjo është një shenjë se sa të shoqërueshëm janë njerëzit këtu", thotë Sandra.

IPK-ja me tetë rekomandime për përdorim të kamerave trupore nga policia

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Inspektorati Policor i Kosovës ka dhënë tetë rekomandime ndaj Policisë së Kosovës pas inspektimit të përdorimit të kamerave të trupit. "IPK në kuadër të raportit i ka dhënë Policisë së Kosovës tetë rekomandime që kanë të bëjnë me nevojën e angazhimit të komisioneve për realizimin e inventarizimeve periodike tremujore sipas Marrëveshjes së Donacionit, organizimin e trajnimeve në përdorimin e kamerave dhe administrimin e provave për zyrtarët policorë të patrajnuar, organizimin e

inspektimeve të kohëpaskohshme mbi funksionimin e sistemit dhe përdorimin e kamerave të trupit", thuhet në njoftimin e IPK-së. Sipas njoftimit, inspektimi ka përfshirë vlerësimin e respektimit të legjislacionit për përdorimin e sistemit të kamerave të trupit, e administrimit të pronës së pranuar si donacion, e efektivitetit në funksionimin e kamerave të trupit, e efektit të sistemit në ngritjen e sigurisë/transparencës/llogari dhënies dhe performancës, si



dhe vlerësimin e masave të sigurisë lidhur me administrimin e provave digjitale. "Inspektimi ka vënë në pah dhe ka adresuar përmes rekomandimit edhe

përdorimin urgjent të kamerave të trupit nga strukturat e Departamentit të Kufirit, zgjerimin e sistemit të kamerave të trupit edhe në njësi të tjera policore, klasifikimin e materialeve të regjistruara për qëllime të ruajtjes dhe administrimit të duhur të tyre", theksohet në njoftimin për medie. Kamerat e trupit të cilat tanimë i ka në dispozicion Policia e Kosovës janë donacion nga Departamenti Amerikan i Shtetit përmes Byrosë për Çështje të Narkotikëve dhe Zbatim të Ligjit.

Lansohet projekti i forcimit të qeverisjes digjitale për ofrimin e shërbimeve

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Kryeministri Albin Kurti mori pjesë në lansimin e Projektit të Forcimit të Qeverisjes Digjitale për Ofrimin e Shërbimeve, të organizuar në partneritet me Bankën Botërore. Sipas kryeministrit Kurti, kjo ngjarje shënon fillimin e një kapitulli të rëndësishëm për rrugëtimin e transformimit digjital të vendit tonë, që ka për synim modernizimin e qeverisjes dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike përmes inovacionit digjital. "Projekti i Forcimit të Qeverisjes Digjitale për Ofrim të Shërbimeve, të cilin po e emërtojmë sot shkurt si Kosova Digjitale, është një nismë ambicioze që mishëron përkushtimin tonë për ta modernizuar ofrimin e shërbimeve publike dhe për të ndërtuar një qeveri të fuqizuar digjitale për qytetarët tanë", u shpreh ai.

Si një vizion dhe zotim i përbashkët, Kosova Digjitale është bashkëdizajnuar dhe mbështetur financiarisht nga Bankat Botërore, me buxhet prej 18.5 milionë eurosh, derisa Qeveria e Japonisë



përmes dy granteve me vlerë prej 800 mijë dollarësh ka mbështetur nisjen e shumë aktiviteteve fillestare dhe përgatitore që janë një ndihmesë e madhe për zbatimin e reformave të parapara në kuadër të Projektit Kosova Digjitale. "Përmes grantit të Qeverisë së Japonisë

tashmë po e finalizojmë dizajnimin e qendrës së parë të integruar të shërbimeve, e cila të funksionojë si një one-stop-shop fizik, ku qytetarët do të mund të marrin shërbime qeveritare në një lokacion të vetëm, me ndihmën e zyrtarëve publikë. Projekti Kosova Digjitale do të

mundësojë realizimin e kësaj iniciative", shtoi tutje kryeministri Kurti. Po ashtu, projekti "Kosova Digjitale" do të kontribuojë edhe në avancimin e mëtejshëm të dritares E-Kosova, e cila ka mbi 986 000 përdorues të regjistruar dhe gati 200 shërbime online

elektronike të lansuara, duke e vendosur qytetarin në qendër dhe duke organizuar shërbimet rreth ngjarjeve jetësore të tij. Në këtë kontekst, kryeministri veçoi ngjarjen jetësore të lindjes së fëmijëve dhe, sipas tij, projekti i ri do të mundësojë që kjo qasje të zgjerohet edhe në ngjarje të tjera jetësore të secilit individ qytetar të republikës. "Në planin e rritjes me Bashkimin Evropian, jemi zotuar se do të digjitalizojmë 50 % të shërbimeve publike deri në vitin 2027, përderisa synimi ynë është që deri në vitin 2030 të digjitalizojmë 100 % të shërbimeve kyçe publike, që është synim i vendeve të Bashkimit Evropian, i përcaktuar në programin e dekadës digjitale 2030 të Bashkimit Evropian". Kryeministri Kurti përfundoi fjalën e tij duke thënë se dita e sotme, 12 dhjetori i vitit 2024, është Ditëlindja e Kosovës Digjitale, derisa kujtoi se Kosova për transferimin digjital nga indeksi GTMI i Bankës Botërore, ka avancuar nga Grupit C i vendeve me fokus të kufizuar, në Grupin B të vendeve me fokus të konsiderueshëm në qeverisje digjitale.

Rektorët bëhen bashkë për politika të mira të arsimit të lartë

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Në Rektoratin e Universitetit të Prishtinës u zhvillua mbledhja e Konferencës së Rektorëve të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë. Në mbledhje drejtuesit e pranishëm të institucioneve publike të arsimit të lartë zgjodhën njëzëri rektorin e Universitetit të Prishtinës, Arben Hajrullahu, kryesues të Konferencës së Rektorëve derisa, gjithashtu, pa vota kundër dhe abstenime, zëvendëskryesues i konferencës u zgjodh Mentor

Alishani, rektor i Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti". Rektori Hajrullahu, duke e konsideruar Universitetin e Prishtinës universitet të përbashkët të të gjithë rektorëve të pranishëm, pasi universitetet e tjera publike nëpër qytetet e mëdha të Kosovës kanë dalë nga UP-ja, tha se qëllimi i takimit është koordinimi për politika sa më të mira të zhvillimit të arsimit të lartë. Në konferencë, përveç rektorëve Hajrullahu e Alishani, morën pjesë: Agron

Bajraktari, rektor i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, Artan Dërmaku, rektor i Universitetit të Gjilanit "Kadri Zeka", Armand Krasniqi, rektor i Universitetit të Pejës "Haxhi Zeka", Drilon Bunjaku, rektor i Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani" dhe Mihane Kerolli, rektore e Kolegjit Publik Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë. Mandati i rektorit Hajrullahu në krye të Konferencës së Rektorëve është njëvjeçar.



Kosova renditet e treta pas Shqipërisë për nivelin e transparencës buxhetore

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Hapur (OBS) tregojnë se Kosova ka shënuar rezultat total prej 50 pikëve nga 100 në Indeksin e Transparencës së Buxhetit. Në këtë aspekt Kosova

renditet e treta ndër shtetet e Ballkanit Perëndimor për nivelin e transparencës buxhetore. Kështu thuhet në raportin rezultateve "Anketa e Buxhetit të Hapur 2023 për Kosovën" të publikuar nga Instituti GAP. Sipas raportit,

Shqipëria tregon performancë më të mirë kryesisht në përmbajtjen gjithëpërfshirëse të disa dokumenteve. Rrona Zhuri nga ky institut ka thënë se Kosova ka më shumë hapësirë për përmirësim në

përfshirjen e hartimit të buxhetit dhe ekzekutimit, duke shtuar se duhet të ofrohen mundësi për më shumë komente. Ajo tha se në këtë anketë Kosova renditet e treta pas Shqipërisë dhe Serbisë.



ZKA-ja dhe Prokuroria e Shtetit angazhohen për rritjen e bashkëpunimit në mbrojtjen e parasë publike

EPOKA ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 12 dhjetor - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), në bashkëpunim me Prokurorinë e Shtetit dhe me mbështetjen e USAID - KMI, kanë mbajtur punëtorinë me temën "Harmonizimi i përkufizimeve të shkeljeve dhe udhëzimet për identifikimin e veprave penale", ku u trajtuan çështjet ligjore që ndërlidhen me mashtrimet e mundshme të identifikuar gjatë procesit të auditimit.

Përveç drejtuesve të lartë dhe përfaqësuesve të tjerë të dy institucioneve dhe Projektit USAID - KMI të pranishëm ishin edhe përfaqësues nga Ambasada e Amerikës.

Auditorja e përgjithshme, Vlora Spanca, tha se angazhimi i përbashkët në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit është e vetmja mënyrë për ruajtjen dhe menaxhimin më të mirë të financave publike. Ajo tha se ky qëllim arrihet duke rritur llogaridhënien dhe transparencën në sektorin publik. "Zyra Kombëtare e Auditimit vazhdon të kontribuojë fuqishëm për të siguruar që institucionet publike mbahen përgjegjëse për veprimet e tyre karshi menaxhimit të parasë dhe pasurisë publike. Çdo vit dërgojmë tek organet për zbatimin e ligjit rastet me elemente të mundshme të mashtrimit apo keqpërdorimit të cilat identifikohen gjatë auditimit", deklaroi ajo.

Ushtruesi i detyrës së kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, tha se mbajtja e kësaj punëtorie është një mundësi e mirë për të diskutuar për punën tonë të përditshme si dhe ky angazhim është në fokus dhe interes të dy institucioneve. Ai tha se ka raste që duken të thjeshta për



t'i trajtuar, por ato kërkojnë kohë dhe angazhim. Në këtë aspekt, Kelmendi tha se ZKA-ja shpeshherë është e shqetësuar për rastet e dërguara dhe ne e mirëkuptojmë sepse secili që ngre një rast ka të drejtë të dije se çfarë ka ndodhur me të. "Ne pranojmë informata nga auditorët dhe pastaj duhet të bëjmë kërkime të tjera e në disa raste edhe të kthehemi tek auditorët për të kërkuar informata shtesë. Në vazhdimësi jemi duke u angazhuar për ta rritur efikasitetin e trajtimit të rasteve", deklaroi Kelmendi.

Drejtoresha e projektit të USAID - Integriteti i Komunave të Kosovës (KMI), Aferdita Mekuli, vlerësoi mbajtjen e kësaj punëtorie dhe angazhimin e dy institucioneve në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. "Për ne është shumë e rëndësishme të shohim se po ndodh kjo ngjarje, sepse

angazhohemi vazhdimisht për t'i mbështetur institucionet në luftimin e korrupsionit dhe mashtrimit. Ne e kemi mbështetur ZKA-në në themelimin e Njesisë Kundër Mashtrimit dhe do ta vazhdojmë përkrahjen tonë. Diskutimi i sotëm është një përpjekje pozitive për të diskutuar për një qasje kohezive nga të dy institucionet", theksoi Mekuli.

Drejtoresha e Departamentit për Çështje Juridike dhe Kundër Mashtrimeve në ZKA, Minire Begaj-Balaj, tha se kjo punëtori i kontribuon forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, rritjes së kapaciteteve profesionale për trajtimin e rasteve dhe qartësimin të përkufizimit të shkeljeve ligjore si dhe adresimin e sfidave në proces. Zëvendësauditori i përgjithshëm, Beza Halilaj, foli për rolin e auditimit dhe bashkëpunimin

ndërinstitucional në identifikimin e mashtrimeve në sektorin publik: sfidat dhe mundësitë për përmirësim. Ai tha se është e domosdoshme të ketë përkufizime të qarta dhe qasje të harmonizuara për t'i identifikuar dhe trajtuar në mënyrë efektive rastet me elemente të mundshme të mashtrimit dhe korrupsionit. Halilaj tregoi se gjatë viteve 2018-2023 në Prokurori të Shtetit janë dërguar rreth 377 raste me elemente të mashtrimit dhe korrupsionit, ndërsa vetëm për vitin 2023 janë dërguar mbi 50 sosh.

Prokurori në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, Bahri Hyseni, theksoi se është me interes për të dy institucionet të ketë sukses në luftimin e korrupsionit dhe mashtrimit. Ai bëri me dije se Prokuroria e Shtetit është e interesuar që rastet e dërguara nga

Zyra Kombëtare e Auditimit të mos mbeten në sirtarë. "Sot do të kemi rastin të diskutojmë dhe të kuptojmë se jo çdo rast përmban elemente të veprës penale. Sa i përket procedimit të rasteve, duhet të bëjmë hapa progresivë. Ne jemi të interesuar për më tepër, të na jepni elemente të veprës penale për faktin që informatat e ngritura të mos jenë thjesht të karakterit administrativ", theksoi Hyseni.

ZKA-ja dhe PSH u pajtuan ta vazhdojnë bashkëpunimin dhe të sigurojnë koordinim të qëndrueshëm në shkëmbimin e informatave për rastet e identifikuar, të vazhdohet mbajtja e punëtorive të tjera si dhe të angazhohen për zhvillimin e platformës elektronike për rastet e mashtrimit dhe kthimin e informacionit ndërmjet dy institucioneve.

ATK-ja fiton dy çmime për parandalimin e korrupsionit

Prishtinë, 12 dhjetor - Në kuadër të Javës Kundër Korrupsionit, organizuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) shënoi një sukses të veçantë.

Dy zyrtarë të ATK-së u vlerësuan me çmime për

angazhimin dhe përkushtimin e tyre të jashtëzakonshëm në parandalimin e korrupsionit. "Këto çmime janë dëshmi e punës transparente dhe profesionale që ATK zhvillon për ta garantuar integritetin dhe llogaridhënien në sektorin

autoritetin tatimor. Ky vlerësim inkurajon ATK-në të vazhdojë përpajra me përkushtim, duke forcuar edhe më tej standardet kundër korrupsionit dhe duke ndihmuar në ndërtimin e një mjedisi më të drejtë dhe të ndershmë për të gjithë", ka njoftuar ATK-ja.



Nëse Inteligjenca Artificiale fshin historinë, realitetin dhe poezinë



Falë Inteligjencës Artificiale, realiteti është fshirë, kreativiteti është zëvendësuar. Nëse nuk e besoni, dëgjoni këto dy histori.

Një herë e një kohë ishte fotografia, e cila dokumentonte realitetin. Nuk mund ta mohojë të vërtetën, është fotoja që dëshmon të vërtetën. Por një ditë një artist nga Nju Jorku, Philip Toledano, porosi një mrekulli nga inteligjenca artificiale. Ai kishte krijuar projektin e titulluar We Are at War për një festival fotografie, me teste të sajura në të cilat Robert Capa, fotografi i famshëm, dokumentoi D-day, ditën e zbarkimit legjendar në bregun e Normandisë. Gjithçka dukej e vërtetë, imazhet, fytyrat, telegramet. Por në fakt, asgjë nuk ishte e vërtetë, gjithçka ishte rezultat i një rindërtimi fiktiv të situatave dhe materialeve.

Iluzionizëm i pastër, vepër e të shkruarit në smartphone, me mbështetjen e Inteligjencës Artificiale, ose më saktë punë prej prestigjatorësh digjitalë. Toledano thotë: Ideja e fotografisë si e vërtetë humbet përgjithmonë. Një risi absolute, apo rikthim në epokën para fotografisë kur historia, përfaqësimi mitik,

piktural, dëshmia gojore e dhënë duhet të provonte një ngjarje, pa asnjë vërtetim të pakundërshtueshëm. Jemi në surrealizëm historik, thotë artisti.

Tani e tutje imazhet nuk do të dëshmojnë më realitetin e gjërave, ato janë të lakueshme. Nga ana tjetër, mjerisht janë të njohura manipulimet që ndodhin në Internet, në rrjetet sociale, me fytyra dhe trupa, shpesh të të miturve, të cilat përdoren në skena të rreme erotike.

Edhe detyra e vëzhgimit prej policisë bëhet e vështirë, pasi pamjet kalojnë dorë më dorë dhe mund të rimodifikohen, shtrembërohen gjatë rrugës, derisa të humbasin gjurmët e fillësës.

Por duke iu rikthyer fotove false historike: një tjetër goditje vdekjeprurëse për kujtesën historike, për vërtetësinë e fakteve. Siç ka ndodhur tashmë në regjimet totalitare – Stalini bëri që figurat e regjimit të diskredituara dhe të eliminuara fizikisht të zhdukeshin nga fotot – ose siç ndodh në manipulimet e sotme të shërbimeve sekrete dhe dezinformatat filmike apo televizive, sot çdokush mund të manipulojë realitetin historik dhe të përziejë ngjarjet aktuale me ato fallco.

Fotografi është i emocionuar nga kjo mundësi e fshirjes së realitetit ose modifikimit të tij sipas dëshirës. Mund ta kthesh realitetin, thotë Toledano, të hysh në vende të paarritshme, të shohësh gjëra që askush nuk i ka parë dhe nuk mund t'i kishte parë kurrë. “Inteligjenca artificiale është tepër fleksibël, mund të jetë si një ëndërr apo një poezi”. Po, e bukur, por nuk është realitet, as e vërteta. A duhet të gëzohemi sepse realiteti po fshihet?

Meqë jemi tek poezia, Inteligjenca Artificiale arrin të simulojë edhe frymëzimin lirik, gjenialitetin poetik. Revista Scientific Report ka botuar kërkime të kryera nga një ekip studiuesish nga Universiteti i Pitsburgut: një grupi prej 1600 personash iu dhanë të përziera, pesë poezi të shkruara nga poetë të mëdhenj, duke filluar nga Shekspiri, dhe pesë poezi të shkruara nga ChatGpt.

Qëllimi ishte të demonstrohej se lexuesit nuk e vërejnë ndryshimin, ata nuk dinë të dallojnë të vërtetën nga e rremja. Dhe sigurisht eksperimenti ishte i suksesshëm. Por mashtrimi është i dyfishtë. Jo vetëm ai i deklaruar nga vargjet e shkruara nga poeti dhe vargjet e shkruara nga Inteligjenca

Artificiale.

Por mashtrimi i vërtetë është krijimtaria e rreme e makinës: ChatGpt gjeneron tekste përmes algoritmeve që mbledhin këngë nga një depo e madhe të dhënash. Ata peshkojnë për vargje në mare magnum-in e universit poetik, nuk ka fare frymëzim krijues.

Operacion matematik pa inteligjencë, montim i saktësisë së lartë teknologjike, por i pafrymëzuar nga një venë lirike dhe krijuese. Nuk ka asnjë poet të prekur pas atyre vargjeve, megjithëse nuk mund të përjashtohet që ato të prodhojnë emocione tek ata që i lexojnë.

Kemi treguar dy histori paralele ose ndoshta konverguese, në të cilat ndodh një gjë dhe ndodhin tre pasoja. Premisa është që kufijtë midis të vërtetës dhe të rremes, midis autentikes dhe falses, midis reales dhe të shpikurës kanë humbur.

Përdoruesi nuk di më të bëjë dallimin midis dy zonave, gjithçka është në mëshirën e Inteligjencës Artificiale. Pasojat që rezultojnë janë të tre llojeve. E para: realiteti, historia, faktet mund të zëvendësohen. E dyta: krijimtaria, frymëzimi poetik, gjenialiteti, mund të zëvendësohen. E treta: njeriu,

si historia dhe si poezia, është i tepërt, ai mund të zëvendësohet. A duhet të gëzohemi apo të shqetësohemi për gjithë këtë, të festojmë apo të frikësohemi, të ekzaltohemi apo të dëshpërohemi? A është ky përparim për njerëzimin, apo një katastrofë?


Inteligjenca artificiale është e çmuar në shumë fusha, ndonjëherë na bën të jetojmë më mirë, zgjeron mundësitë tona të jetës dhe njohurive.

Megjithatë, me tre kushte. E para është se ne mund të dallojmë të vërtetën nga e gënjeshtërtë, poezinë nga letrat tarot, poetin nga roboti; domethënë se ka ende mjete për të ndarë të parat nga të dytat.

E dyta është se fuqia e teknologjisë mund të balancohet me njohuri kritike, inteligjencë në shkallë njerëzore, një kulturë të aftë për të kompensuar rritjen e IA dhe njeriu mund të orientojë, filtrojë, kontrollojë dhe drejtojë Teknikën pa u drejtuar prej saj. E treta është se zgjerimi i Inteligjencës artificiale mund të ndalet kur bëhet shqetësues dhe i rrezikshëm për njerëzimin dhe botën. Pra, njeriu të kalërojë tigrin dhe të mos tërhiqet zvarrë dhe në fund të dërrmohet. / bota.al



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Vdes futbollisti i Vushtrrisë, Erjon Morina

VUSHTRRI, 12 DHJETOR - Ka vdekur futbollisti i Vushtrrisë Erjon Morina. Lajmi u bë i ditur nga familjarët. "Ylli babit ike në qiell. Na thave zemrat Erjon! Do jetojmë të ngrysuar

me kujtimet me të bukura për ty! Do jesh ylli që do na ndriçon gjithmonë", ka shkruar babai i tij Iliri. 22-vjeçari për disa javë kishte qenë i shtrirë në spital në

gjendje të rëndë shëndetësore. Ai kishte pësuar sulm gjatë stërvitjeve. Erjon Morina, kishte një karrierë të bujshme para vetës. Morina karrierën e filloj te Fc Prishtina, derisa ka

luajtur edhe për skuadra të tjera në Kosovë si Besa Pejë, Drenica, 2 Korriku, Llapi, Malisheva, Ulpiana dhe së fundmi ishte pjesë e Vushtrrisë.



Bashkimi dhe Vëllaznimi kualifikohen në gjysmëfinale

"Epoka e re"

PRIZREN, 12 DHJETOR - Bashkimi u kualifikua në gjysmëfinale të Kupës. Prizrenasit edhe në ndeshjen e dytë, fituan ndaj Borës, me shifrat 97:74 (20:21, 26:27, 25:11, 26:15). Fitorja në Prishtinë me 22 pikë dallim, 66:88, ishte e madhe për prizrenasit, që me një këmbë ishin në gjysmëfinale. Në sfidën e dytë gjysmëfinale të zhvilluar në Prizren, pjesa e parë ishte kryesisht e barabartë, duke përfunduar 46:48, derisa në pjesën e dytë, vendasit ishin më të mirë, dhe u shkëputën për të triumfuar me rezultat 97:74. Te vendasit u dalluan Robert Rikiq me 18

pikë e gjashtë kërcime dhe Lejson Zeqiri me 17 pikë, ndërsa te mysafirët më i miri ishte Dion Haxhosaj me 18 pikë, gjashtë kërcime e katër asistime. Bashkimi në gjysmëfinale do të ndeshet me Vëllaznimin, derisa gjysmëfinalja tjetër zhvillohet ndërmjet Trepçës dhe Sigal Prishtinës. Edhe në gjysmëfinale, do të zhvillohen dy ndeshje vajtje-ardhje, ndërsa finalja e Kupës do të jetë në shkurt të vitit të ardhshëm. Ndërsa Vëllaznimi është skuadra e katërt gjysmëfinaliste e Kupës së Kosovës. Kuqezinjtë pësuan nga Golden Eagle Ylli me rezultat 98:91 (19:20, 30:22, 22:26, 27:23), por fitorja e



ndeshjes së parë me 18 pikë dallim 100:82, ishte vendimtare që të kalojnë në

gjysmëfinale. Therandasit u munduan që të bëjnë rikthimin e madh, por

mysafirët nuk e lejuan një gjë të tillë, duke mos rrezikuar depërtimin në mesin e katër më të mirave të kësaj gare, shumë të rëndësishme për basketbollin e Kosovës. Te vendasit u dalluan Jalen Nesbitt me 19 pikë, pesë kërcime e tri asistime dhe Quade Green me 30 pikë, ndërsa te kuqezinjtë më i miri ishte Arian Azemi me 22 pikë, dhjetë kërcime e shtatë asistime. Vëllaznimi do të ndeshet me Bashkimin në gjysmëfinale, derisa gjysmëfinalja tjetër zhvillohet ndërmjet Trepçës dhe Sigal Prishtinës. Edhe në gjysmëfinale, do të zhvillohen dy ndeshje vajtje-ardhje, ndërsa finalja e Kupës do të jetë në shkurt të vitit të ardhshëm.

Rahoveci i pandalshëm, fiton edhe derbin me Kastriotin



RAHOVEC, 12 DHJETOR - Rahoveci nuk po ka të ndalur në Superligën e Kosovës në hendboll në konkurrencë të meshkujve. Të enjten mbrëma në palestrën "Mizahir Isma", Rahoveci e fitoi ndeshjen e fortë me Kastriotin me rezultat 35:32. Ashtu si pritej, ndeshja ishte betejë e vërtetë, ndonëse vendasit vazhdimisht ishin në epërsi. Por ferizajasit nuk kanë ndalur deri në fund përpjekjet për barazim. "Vreshtarët" nisën takimin me seri 5:1,

ndërsa më pas mbajtën epërsi solide deri në fund të pjesës së parë. Mysafirët nisën më mirë pjesën e dytë dhe pas një serie 4:0 u afruan në 17:16 në minutën e 35-të. Por më pas lojtarët e Rahovecit lidhën tri gola për 20:16. Kastrioti nuk ia dolet të afrohet më. Egzon Gjuka udhëhoqi Rahovecin me shtatë gola. Nga gjashtë i kishin Alban Haziri e Antonio Vozila. Arbër Curri kontribuoi në fitore me shumë pritje. Wadi Chebbi, portieri i

Kastriotit, shfaqti formë të lartë sidomos në 40 minutat e parë. Por ferizajasit nuk përfituan shumë nga kjo. Më efikas ishte Deniz Terziqi me dhjetë gola. Nga pesë i kishin Vlerson Zherka, Lulzim Shabani, Rron Ramadani e Alecsander Santos. Rahoveci e shënoi fitoren e 12-të rresht. Udhëheq në tabelë me 24 pikë. Kastrioti është i treti me 18 pikë. Ndeshja e së enjtes ishte e shtyrë dhe i takoi xhiros së 11-të.

Ademi: Kosova dëshiron të përfaqësohet në Botërorin e ShBA-së

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi ka bërë të ditur se së bashku me përzgjedhësin Franco Foda, po qëndrojnë në Cyrih, ku sot do të bëhet tërheqja e shortit për Kupën e Botës 2026. Ademi ka thënë se shpreson që Kosova të ketë një short sa më të favorshëm, në


mënyrë që të mund të jetë pjesë e këtij eventi madhështor. "Ky është një moment i rëndësishëm për ne dhe shpresoj që Kosova të ketë një short sa më të favorshëm, në mënyrë që të mund të jemi pjesë e këtij eventi madhështor. Motivi është i jashtëzakonshëm, pasi Kosova dëshiron të përfaqësohet në

Botërorin e SHBA-së, një vend që e ka mbështetur fuqishëm shtetin tonë dhe që na ka ndihmuar të arrijmë deri këtu ku jemi sot", ka thënë Ademi. "Të mërkurën u mbajt edhe Kongresi i FIFA-s, ku morëm pjesë në formatin online. Iu gëzuam lajmit që Kupa e Botës 2030 do të zhvillohet në Spanjë, Portugali dhe Maroko, por që

njëkohësisht për nder të 100-vjetorit të këtij eventi, tre ndeshje do të luhen në Uruguai, Paraguai dhe Argentinë, duke nisur nga Uruguai, ku u mbajt Botërori i parë në vitin 1930. Ndërkohë, në të njëjtin Kongres u vendos që Botërori 2034 do të zhvillohet në Arabinë Saudite, një tjetër vend mik i Kosovës. Uroj që Kosova të jetë në këto



kampionate dhe të paraqesim vlerat tona të futbollit, por edhe si shoqëri", ka shtuar Ademi.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS

KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Në bazë të nenit 57 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shendetësor, Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe nenin 5 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ (MFPT) Nr. 01/2024 për Rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Oda e Mjekëve të Kosovës shpall këtë:

KONKURS

Për plotësimin e vendit të punës

Titulli i vendit të punës:	Sekretar i Përgjithshëm i Odës së Mjekëve të Kosovës (1) poziti
I raporton:	Kryetarit të OMK-së
Niveli i pagës:	9.71
Orët e Punës:	40 orë në javë
Kohëzgjatja e Kontratës:	Kohë e pacaktuar
Vendi Punës:	"Instituti A" QKUK, 10 000 Prishtinë

Detyrat e përgjithshme:

- Siguron këshilla të politikave për Kryetarin dhe organet e tjera të OMK-së;
- Siguron që vendimet e politikave dhe masat tjera të organeve të OMK-së të zbatohen në mënyrë efikase dhe efektive;
- Siguron që masat zbatuese të Odës të monitorohen rregullisht dhe që të merren masa korrigjuese në rast të pengesave;
- Lëshon urdhëresa dhe udhëzime për kryerjen e punëve me miratim të organeve të OMK-së;
- Menaxhon personelin e Shërbimit Profesional;
- Menaxhon rrjedhën e informacionit në OMK;
- Bashkëpunon me sekretarët e Odave tjera në baza të rregullta;
- Koordinon raportin e organeve të OMK-së me organet e saj vartëse administrative; dhe
- Kryen edhe punë të tjera sipas legjislacionit në fuqi dhe sipas kërkesës së Kryetarit të OMK-së dhe Këshillit Drejtues të OMK-së.

Kualifikimet:

- Të jetë i diplomuar në ndonjërin nga degët e fakulteteve si: Mjekësi, Juridik, Ekonomik, Administratë Publike apo të avancuar (studime master të fushës së menaxhimit);
- Së paku 3 (tre) vite përvojë pune menaxheriale pas diplomimit

Aftësitë:

- Të ketë shkathtësi në përcaktimin dhe arritjen e objektivave strategjike të institucionit, aftësi të larta organizative dhe drejtuese, aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit dhe negociimit, aftësi të dëshmuara për analizën e gjendjes dhe ofrimin e opsioneve, njohuri të standardeve të integritetit, ndershmërisë dhe drejtësisë;
- Plotëson edhe kushtet e përgjithshme të parapara me Ligj dhe Statutit të OMK-së;
- Njohja e gjuhës angleze e obligueshme;
- Njohja e punës me kompjuter në softuer të nevojshëm për kryerjen e punëve;

Mënyra e aplikimit;

Aplikimi bëhet vetëm në mënyrë elektronike në adresën: info@omk-rks.org

Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe email adresën. Vetëm kandidatët që plotësojnë kriteret e konkursit do të ftohen në procedura të tjera të rekrutimit.

Dokumentet që duhet të bashkangjiten:

- Aplikacioni i OMK-së **Formulari i aplikimit**
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë;
- Kopjet e dëshmisë së punësimit të cilat dëshmojnë përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë.
- Dëshmitë e trajnimeve profesionale të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit.

Shënim: Aplikacionet që arrijnë pas afatit të përcaktuar në konkurs dhe ato të pakompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen. Procedura e rekrutimit do të bëhet në bazë të Udhëzimit Administrativ (MFPT) Nr. 01/2024 për Rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Oda e Mjekëve të Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë burrë apo grua dhe nga të gjitha komunitetet në Republikën e Kosovës.

Shpallja është e hapur deri më 25.12.2024 në ora 16:00.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr. tel.: 049/872-300 apo 038/544-872.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS

KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Na osnovu člana 57. Zakona br. 04/L-150 o komorama zdravstvenih profesionalaca, član 8. Zakona br. 03/L-212 o radu, kao i člana 5. i 7. Administrativnog uputstva (MFRT) br. 01/2024 o regulisanju konkursnih postupaka za zasnivanje radnog odnosa u javnom sektoru, Lekarska komora Kosova raspisuje ovaj:

KONKURS

Za popunjavanje radnog mesta

Naziv radnog mesta:	Generalni sekretar Lekarske komore Kosova (1) pozicija
Izveštava:	Predsedniku LKK-a
Koeficijent plate:	9.71
Radni sati:	40 sati nedeljno
Trajanje ugovora:	Na neodređeno vreme
Radno mesto:	„Institut A“ UKCK, 10 000 Priština

Opšte dužnosti:

- Daje savete o politici predsedniku i drugim organima LKK-a;
- Obezbeđuje da se odluke o politici i druge mere organa LKK-a primenjuju na efikasan i delotvoran način;
- Obezbeđuje da se mere sprovođenja Komore redovno prate i da se preduzimaju korektivne mere u slučaju prepreka;
- Izdaje naloge i uputstva za obavljanje poslova uz saglasnost organa LKK-a;
- Upravlja osobljem Stručne službe;
- Upravlja protokom informacija u LKK-u;
- Redovno sarađuje sa sekretarima drugih komora;
- Koordinira odnose organa LKK-a sa njenim podređenim upravnim organima; i
- Obavlja i druge poslove u skladu sa važećim zakonodavstvom i na zahtev predsednika LKK-a i Upravnog odbora LKK-a.

Kvalifikacije:

- Da je diplomiran na nekom od ogranaka fakulteta, kao što su: Medicina, Pravo, Ekonomija ili Javna uprava ili napredne studije (master studije u oblasti rukovođenja);
- Najmanje 3 (tri) godine radnog iskustva u rukovođenju nakon diplomiranja.

Veštine:

- Da poseduje veštine u postavljanju i ostvarivanju strateških ciljeva institucije, visoke organizacione i liderske veštine, odlične komunikacione i pregovaračke veštine, dokazane veštine analize situacije i nudenja opcija, poznavanje standarda integriteta, poštenja i pravde;
- Da ispunjava i opšte uslove predviđene Zakonom i Statutom LKK-a;
- Poznavanje engleskog jezika je obavezno;
- Poznavanje rada na računaru sa potrebnim softverom za obavljanje poslova.

Način podnošenja prijave;

- Podnošenje prijave se vrši samo u elektronskom obliku na adresi: info@omk-rks.org
- Kandidati koji konkurišu treba da tačno unesu adresu, broj telefona za kontakt kao i e-mail adresu. Samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume konkursa biće pozvani na dalje postupke zapošljavanja.

Dokumente koje treba priložiti:

- Prijava LKK-a **Obrazac prijave**
- Kopija lične karte;
- Kopija diplome koja se traži konkursom, izdata od strane obrazovanih ustanova Republike Kosova. Ako je diploma stečena u inostranstvu, potvrda o nostrifikaciji stečene diplome ili akt koji dokazuje da je stečena diploma u postupku nostrifikacije, pod uslovom da se nostrifikacija diplome dostavi do trenutka potpisivanja akta o imenovanju na poziciji;
- Kopije potvrde o zaposlenju kojom se dokazuje radno iskustvo, koja definiše radno mesto kao i trajanje angažovanja na toj poziciji.
- Dokazi o pohađanju stručnih obuka ili obuka koje je podnosilac prijave održao u svojstvu predavača.

Napomena: Pristigle prijave nakon roka koji je propisan konkursom i nepotpune prijave sa relevantnom dokumentacijom, neće biti razmatrane. Procedura zapošljavanja će se zasnivati na Administrativnom uputstvu (MFPT) br. 01/2024 za Uređenje postupka za zasnivanje radnog odnosa u javnom sektoru.

Lekarska komora Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Republike Kosova i pozdravlja prijave svih lica muškog ili ženskog pola i svih zajednica u Republici Kosova.

Konkurs je otvoren do 25.12.2024. godine u 16:00 časova.

Za detaljne informacije možete kontaktirati brojeve telefona: 049/872-300 ili 038/544-872.



ROYAL CROWN
RC
cola

**ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS**

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908
0.5L



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

